

Titulli i lëndës: SHQIPJA LETRARE E SHEKUJVE XVI-XVIII

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Dega e Gjuhës Shqipe
Titulli i lëndës:	Shqipja letrare e shekujve 16-18
Niveli:	BA (Baçelor)
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti II Semestri IV
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	7 ECTS
Koha / Vendi:	Klasa Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. ass. dr. Shpëtim Elezi
Të dhënat kontaktuese:	shpetim.elezi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Shqipja letrare e shekujve 16-18 ka për objekt gjuhën e teksteve të vjetra shqipe. Përmes përshkrimit të gjuhës së veprave të autorëve të vjetër pasqyrohet edhe gjendja e shqipes së kësaj faze të dokumentuar. Me theks të veçantë, kursi heton dhe pasqyron elemente konservative dhe inovatore të shqipes së teksteve të vjetra në të gjitha sistemet gjuhësore, në sistemin grafemor, në sistemin fonetik, në sistemin gramatikor dhe në sistemin leksikor. Në planin sinkronik, përshkruhen veçoritë gjuhësore të secilit autor dhe, duke i vështruar ato veçori në përqasje me gjuhën e autorëve të tjerë të vjetër, ndërtohet një paradigmë e zhvillimit diakronik të shqipes së kësaj faze shkrimore. Tekstet e vjetra të autorëve të shekujve 16-18 kanë një vlerë të rëndësishme gjuhësore, kështu që njohja, leximi, transkribimi dhe komentimi i tyre janë me shumë rëndësi për studentët e gjuhës shqipe. Për trajtime më të specializuara të çështjeve, kursi e orienton studentin duke i ofruar bibliografi të specializuar.
Qëllimet e lëndës:	Kjo lëndë është ndër kurset formuese që synon t'u ofrojë studentëve njohuri gjithëpërfshirëse për gjendjen dhe zhvillimin e strukturës së shqipes letrare të shekujve 16-18. Kursi synon t'u krijojë mundësi studentëve që të marrin dije themelore e të specializuar për të pasur më të lehtë leximin dhe transkribimin e teksteve të vjetra. Këto tekste janë botuar tashmë me aparaturë të nevojshme – transkribim e shënime kritike. Njohja e vlerave dhe e veçorive gjuhësore të këtyre teksteve u jep mundësi studentëve të njohin faza më të hershme të zhvillimit historik të gjuhës shqipe. Qëllimi është që studentët t'i thellojnë dijet e tyre në lidhje me zhvillimin e strukturës së shqipes në diakroni në një dimension sistemi të pashkëputur nga shqipja e dokumentuar e kësaj faze gjer në fazat më të hershme.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti: - identifikon alfabetet e përdorura nga autorët e vjetër të shek 16–18. - lexon tekstet e vjetra të kësaj faze shkrimore.

	• transkripton tekste të vjetra të shek 16-18.
	• bën lexim kritik të teksteve të vjetra.
	• heton ngjashmëri dhe dallime gjuhësore në mes autorëve të vjetër.
	• krahason elemente gjuhësore ndërmjet teksteve të autorëve të vjetër.
	• analizon veçori gjuhësore të shqipes së shekujve 16-18.
	• argumenton me shkrim lidhur me gjendjen e shqipes së teksteve të vjetra.

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë / Javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	22.5
Ushtrime	2	15	22.5
Përgatitje për test intermediar	3	4	12
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	15	2.5
Testi, punimi i seminarit	2	2	4
Detyrë shtëpie	3	15	45
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	4	15	60
Përgatitja për provimin final	2	4	8
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	4	1	4
Totali			184.5 orë 184.5:25=7.38 7 ECTS

Metodat e mësimdhënies:	Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike dhe ushtrimeve që ofrojnë bazën praktike. Mësimdhënia gjatë ligjëratave organizohet nëpërmjet një diskutimi interaktiv për tema të caktuara, kurse gjatë ushtrimeve mësimdhënia orientohet kah studentët. Në orët e ushtrimeve mësimdhënësi e menaxhon dhe lehtëson rrjedhën e orës, duke krijuar mundësi që studentët të lexojnë, të transkriptojnë, të komentojnë, të diskutojnë e të japin mendime të argumentuara lidhur me gjuhën e autorëve të vjetër të shek. 16-18, kurse sipas nevojës shpjegon e sqaron konceptet e diskutueshme e të paqarta. Studentët do të kenë detyra të vazhdueshme në klasë dhe në shtëpi dhe punime seminari të kryera në mënyrë të pavarur e individuale, por bëjnë edhe punë individuale e në grupe, si dhe realizojnë projekte që i prezantojnë në klasë për të cilat diskutojnë bashkërisht.
Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 51%. • Vijueshmëria (L + U) 5% • Angazhimi (L + U) 5% • Transkribimi (U) 10% • Prezantimi 10% • Seminari 10% • Kolokuiumi I 30% • Kolokuiumi II 30% Gjithsej 100%: 51-60% (nota 6), 61-70 (7), 71-80 (8), 81-90 (9), 91-100 (10).
Literatura bazë:	1. Ismajli, R. (2000). Tekste të vjetra. Pejë: Dukagjini.
Literatura shtesë:	1. Ashta, K. (1996). Leksiku historik i gjuhës shqipe. I-VII. Shkodër: Universiteti “Luigj Gurakuqi”. 2. Bokshi, B. (2010). Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes. Prishtinë: ASHAK.

3. Cesarini-Martinelli, L. (2007). Filologjia. (Përktheu A. Doka). Tiranë.
4. Çabej, E. (1976). Studime gjuhësore III. Prishtinë: Rilindja.
5. Çabej, E. (1977). Gjon Buzuku dhe gjuha e tij. Në: "Studime gjuhësore VI", Prishtinë: Rilindja.
6. Çabej, E. (2013). Meshari i Gjon Buzukut (1555). Botim kritik. Tiranë.
7. Demiraj, B. (2006). Gjon P. Nikollë Kazazi dhe "Doktrina" e tij. Prishtinë: ASHAK.
8. Demiraj, B. (2008). Dictionarium latino-epiroticum (Romae 1635) per R.D. Franciscum Blanchum. Shkodër: Botime Françeskane.
9. Demiraj, Sh. (1988). Gramatikë historike e gjuhës shqipe. Prishtinë: Rilindja.
10. Demiraj, Sh. (1989). Gjuha shqipe dhe historia e saj. Prishtinë: Rilindja.
11. Elezi, Sh. (2018). Sistemi emëror i shqipes në veprën e Pjetër Bogdanit (shek. XVII). Disertacion doktrate. Tiranë: ASA. Në: <https://drive.google.com/file/d/1AhDHI9wzuQOoIl1wabp5cVT28ZQ8-oTO/view>
12. Elezi, Sh. (2019). Sistemi përemëror i shqipes në veprën e Bogdanit. Prishtinë: ZeroPrint.
13. Fiedler, W. (2004). Das Albanische Verbalsystem in der Sprache des Gjon Buzuku (1555), Prishtinë: ASHAK.
14. Hysa, M. (1987). Krestomaci e letërsisë së vjetër shqiptare. Prishtinë.
15. Ismajli, R. (1982). Gramatika e parë e gjuhës shqipe. Botim kritik. Prishtinë: Rilindja.
16. Ismajli, R. (1985). Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706). Prishtinë.
17. Ismajli, R. (2021). Për historinë e gjuhës shqipe. Prishtinë: ASHAK.
18. Mandalà, M. (2004). Luca Matranga. E mbsuame e krështerë. Edizione critica dei testi manoscritti e a stampa (1592), S. Sciascia Editore, Caltanissetta.
19. Matzinger, J. (2006). Der Altalbanische Text E Mbsuame e Krështerë (Dottrina cristiana) des Lekë Matrënga von 1592. Eine Einführung in die albanische Sprachwissenschaft. Dettelbach, J. H. Röhl Verlag, 306 S., in: "Kratylos"(4 S. – im Druck).
20. Mulaku, R. (2012). Gjuha e shkrimeve të vjetra shqipe (shek. XV-XVIII). Prishtinë: IAP.
21. Omari, A. (2015). Pjetër Bogdani. Cuneus Prophetarum (Çeta e profetëve). Botim kritik. Tiranë: ASHSH.
22. Omari, A. (2016). Leksiku i veprës së Pjetër Bogdanit. Tiranë: QSA.
23. Paci, E. (2011). Sistemi mbiemëror në Mesharin e Gjon Buzukut (Studim monografik). Tiranë: QSA, IGJL.
24. Ressuli, N. (1958). Il "Messale" di Giovanni Buzuku, riproduzione e trascrizione, Città del Vaticano.
25. Ressuli, N. (1978). I più antichi testi albanesi. Torino.
26. Riza, S. (1996-2009). Vepra I-V. Prishtinë: ASHAK.
27. Roques, M. (1932). Recherches sur les anciens textes albanais. Paris. (Versioni shqip në: M. Roques, "Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe", Buletin i Institutit Pedagogjik të Shkodrës, 1964 (numër i posaçëm).
28. Sciambra, M. (1965). Bogdanica. Studi su Pietro Bogdani e l'opera sua, volume II, Saggio sul lessico scientifico e culturale del Bogdani, ed. Pàtron, Bologna.
29. Sulejmani, F. (1970). E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës. Prishtinë.
30. Shala, H. (1017). Sistemi foljor në veprën e Pjetër Bogdanit. Tiranë: QSA, IGJL.
31. Shuteriqi, Dh. (2005). Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800. Tiranë: ASHSH, IGJL.
32. Topalli, K. (2011). Gramatikë historike e gjuhës shqipe. Tiranë: QSA.
33. Trofenik, R. (1977). Cuneus prophetarum a Pietro Bogdano, Patavii

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Historia e shqipes letrare. Tradita filologjike shqipe, një histori e zbulimit dhe e botimeve të teksteve të vjetra
Java 2:	Objekti dhe metodat e filologjisë. Konceptet e filologjisë si kritikë teksti. Zhvillimi historik i filologjisë. Filologjia si disiplinë shkencore. Botimi kritik
Java 3:	Shek. XV. Dokumentet më të vjetra shqip: Formula e pagëzimit, Epirota (Fraza e mallkimit), Fjalorthi i Arnold von Harffit, Perikopeja e Ungjillit
Java 4:	Shek. XVI. Qarku katolik verior. Libri i parë shqip dhe rrethanat e shkrimit të tij. Botimi kritik i “Mesharit” të Buzukut nga Çabej dhe kriteret e tij. Modeli i Çabejt dhe modeli i Resulit
Java 5:	Veçori gjuhësore të Buzukut. Lexim teksti nga Buzuku me analizë grafike e gjuhësore dhe komente nga “Meshari”. Detyrë kursi: transkriptim e komentim tekstesh
Java 6:	Shek. XVI. Qarku i letërsisë arbëreshe. Lekë Matrënga dhe katekizmi i tij “Embsuame e krështerë”. Rrethanat historiko-kishtare të përkthimit të veprës. Botimi kritik nga M. Mandalà
Java 7:	Çështje të grafisë së tekstit të Matrëngës dhe veçori gjuhësore. Lexim tekstesh nga Matrënga me analizë grafike e gjuhësore dhe komente. Detyrë kursi: transkriptim e komentim tekstesh (<i>KOLOKUIUMI 1</i>)
Java 8:	Shek. XVII. Pjetër Budi dhe personaliteti i tij. Veprat e Budit. Botimi kritik i teksteve të tij, çështje të grafisë, kriteret e botimit
Java 9:	Veçori gjuhësore të Budit. Lexim tekstesh nga Budi me analizë grafike e gjuhësore dhe komente. Detyrë kursi: transkriptim e komentim tekstesh
Java 10:	Frang Bardhi dhe Fjalori i tij. Botimi i fundit kritik dhe kriteret e botimit
Java 11:	Veçori gjuhësore të Bardhit. Lexim tekstesh nga Bardhi me analizë grafike e gjuhësore dhe komente. Detyrë kursi: transkriptim e komentim tekstesh
Java 12:	Pjetër Bogdani dhe vendi i tij në historinë kulturore të shkrimit shqip. Cuneus Prophetarum. Botimi kritik nga A. Omari dhe kriteret e tij
Java 13:	Veçori gjuhësore të Bogdanit. Lexim tekstesh nga Bogdani me analizë grafike e gjuhësore dhe komente. Detyrë kursi: transkriptim e komentim tekstesh
Java 14:	Shek. XVIII. Tradita e letërsisë arbëreshe. Jul Variboba dhe vepra e tij “Gjella e Shën Mëris Virgjër”. Botimi kritik dhe kriteret e tij. Veçori gjuhësore të Varibobës. Lexim tekstesh nga Variboba me analizë grafike e gjuhësore dhe komente. Detyrë kursi: transkriptim e komentim tekstesh (<i>KOLOKUIUMI 2</i>)
Java 15:	Shek. XVIII. Dorëshkrimi anonim i Elbasanit dhe tradita letrare elbasanase. Shkrimi i shqipes me alfabetë të posaçme. Lexim teksti nga Anonimi me analizë gjuhësore (<i>PREZANTIMET</i>)

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar t'i vijnë me rregull ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk lejohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti u nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së. Sjellja e mësimdhënësit dhe e studentëve bazohet në kodin e mirësjelljes dhe të etikës në kuadër të UP-së.